



## RELACION TEKNIK

### NDËRTIM I AMBJENTEVE SPORTIVE SHKOLLA 'PRENG JAKOVA' (Jeto me sportin)

Shkoder 2024

## I. HYRJJE

Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore, është një ndër prioritetet kryesore të Bashkisë Shkodër.

Rikualifikimi i objekteve me funksione arsimore dhe rikonceptimi i tyre, ku përdorimi të mos jetë i kufizuar vetëm gjatë orarit të punës, por ti shërbejë si punonjësve ashtu edhe komunitetit, kërkon një ndërhyrje emergjente, në përputhje me nevojat specifike të çdo institucioni.

Vizioni i Bashkisë Shkodër është transformimi i territorit në një hapsirë politcentrike që ofron shërbime më të njëjtin standard për publikun në mënyrë të thjeshtë dhe të aksesueshme nga banorët dhe vizitorët. Ndërtimi i komplekseve sportive stërvitore, është kusht për rritjen e cilësisë sportive. Krijimi i ambjenteve sportive synon promovimin e sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti për komunitetin.

Projekti synon të përfshijë të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke ofruar shërbimin me të njëjtin standard, si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale, duke nxitur përfshirjen e komunitetit në zhvillimin e aktiviteteve sportive.

## II. GJENDJA AKTUALE E OBJEKTIT

### Vendndodhja

Rikualifikimi i ambjenteve sportive shkolla ‘Preng Jakova’ ndodhet në Shkodër, në rrugën ‘Martin Camaj’, zona kadastrale 8593, me numër pasurie 3/35. Sheshi rrethohet nga Godina e Shkollës dhe nga konvikti, është një zone mjaft e kufizuar me ndertime ng ate te gjitha anët. Në shkollën e mesme ‘Preng Jakova’ mesojnë rreth 311.





## Problematikat e infrastrukturës ekzistuese


Sheshi i ndërtesës, me një sipërfaqe rreth 8000 m<sup>2</sup>, aktualisht nuk mund të shfrytëzohet për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e sheshit është e pashtuar, një pjesë e madhe e terrenit ku zhvillohet aktivitete sportive është në gjendje jo të mirë gjë që pengojnë në ushtrimin e normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht sheshi është i papërshtatshme për çdo aktivitet sportiv dhe rekreativ.



### III. REALIZIMI PROJEKTIT

#### Objektivi

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Bashkisë Shkodër duke i mundësuar çdo fëmije, të riut dhe të reje që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare nëpërmjet pjesmarrjes aktive në aktivitetet sportive. Është menduar që të krijohen një fushe basketbolli që do të shërbejnë dhe për volejball, me përmasa 28 x 15 m. Sheshi do të jete me gjelberim dhe stola për te krijuar dhe një ambient rekreativ.







Paketa e shtresave që do të perdoret:

PAKETA E SHTRSAVE  
MBI SHTRSAT EKZISTUESE  
TE BETONIT

PRIMER + SHTRSE RERE SILICE + VESHJE POLIURETANI ME NGJYRE

SHTRSE LLUSTER CIMENTO t=2cm

SHTRSE BETONI EKZISTUESE



PAKETA E SHTRSAVE  
ME ASFALT EKZISTUES

PRIMER + SHTRSE RERE SILICE + VESHJE POLIURETANI ME NGJYRE

SHTRSE ASFALTOBETONI ME ZALL LAVATRICE t= 3cm

SHTRSE BANDERI ME ZALL LAVATRICE t=3cm (profilim)

SKARIFIKIM SHTRSE ASFALT EKZISTUESE



PAKETA E SHTRSAVE  
TE REJA

PRIMER + SHTRSE RERE SILICE + VESHJE POLIURETANI ME NGJYRE

SHTRSE ASFALTOBETONI ME ZALL LAVATRICE t= 3cm

SHTRSE BANDERI ME ZALL LAVATRICE t=3cm

SHTRSE STABILIZANTI t=10cm

SHTRSE EKZISTUESE





Rimodelimi i territorit e kthen të gjithë sheshin në një hapësirë multi funksionale. Sheshin përpara ndërtesës është menduar si një hapësirë rekreative e cila mund të përdoret si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhet Shkolla

Ing. Florinda Hilaj  
Ing . Viktor Sheldija